

**STATUT I SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MC Food” SHPK**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë
organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu*

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Neni 1

- 1.1** Shoqeria “Mc Food” SHPK themelohet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (te ndryshuar).

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia**

Neni 2

Emri dhe Ortaket

- 2.1** Shoqeria identifikohet nepermjet emrit te saj “Mc Food” SHPK, ne cilesine e nje personi juridik shqiptar sipas formes “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”.
- 2.2** Ortakaket e shoqerise jane:
- 1.** **Izet Sheqiri**, shtetas Kosovar, i biri i Osman, lindur me 23.12.1968 ne Prishtine, banues ne Prishtine, mbajtes i pasaportes me Nr. personal P00873094, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;
 - 2.** **Bledar Habili, Bledar Habili**, shtetas shqiptar, i biri i Azem, lindur me 17.03.1985 ne Kavaje, banues ne Kavaje, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr. 032937248 dhe Nr. Personal I50317110F, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar

Neni 3

Objekti

- 2.1** Tregtimi me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e industriale, fruta perime, automjete, pjese kembimi, prodhim dhe tregtim materiale ndertimi, inerte, etj.
- 2.2** Therje-perpunim mishi,import-eksport mishi te llojeve te ndryshme.
- 2.3** Magazine frigoriferike per mallara ushqimore.

Neni 4

Kohezgjatja

- 4.1** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Neni 5

Selia



- 5.1** Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Autostrada Durres-Kavaje, Km 7,Rruga 1 maji Qerret Kavaje, Shqiperi.
- 5.2** Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.
- 5.3** Adresa e faqes se internetit te Shoqerise eshte www.mcfood.al
Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte info@mcfood.al

KREU II

Neni 6

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 6.1** Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren prej 250.000 (Dy qind e pese dhjete mije) Euro dhe ndahet si me poshte:
- 6.2** Kuotat e Kapitalit jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga Ortaket e shoqerise.

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Vlera (Euro)	Perqindja
1.	Izet Sheqiri	1 (nje)	150.000 (Nje qind e pese dhjete mije)	60% (gjashte dhjete)
2.	Bledar Habili	1 (nje)	100.000 (Nje qind mije euro)	40% (dy zete)
	Totali	2 (dy)	250.000 (Dy qind e pesedhjete mije euro)	100% (njqind)

Neni 7

Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

- 7.1** Administratori u kerkon ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej 14 (katermbedhjte) Ditesh te Plota ne te cilin percaktohet koha dhe vendi i kryerjes se pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te kontributeve te papaguara. Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavaresisht kalimit te mepashem te pronesis se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.
- 7.2** Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve, pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratori njofton paraprkisht te pakten 14 (katermbedhjte) Dite te Plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumat e mundshme shtese te kamatevoneses. Njoftimi do te permbaje vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklarimin se ne rast moszbatimi te tij, kuotat te cilave u referohet njoftimi do te anulohen.
- 7.3** Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Asamblese se

- 7.3 Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi, perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit, mund te anulohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe anulimi do te perfshije te gjitha dividendet ose shumatat tjera te pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluarat dhe te papaguara deri ne momentin e anulimit.
- 7.4 Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund te shitet, rishperndahet ortakeve ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Asambleja e Pergjithshme konsideron te pershtatshme.
- 7.5 Personi, kuota e te cilit eshte anuluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatevonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

Neni 8

Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve

- 8.1 Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave se ortakeve, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit.

Neni 9

Pronesia dhe Certifikatat e kuotave

- 9.1 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit te saj ("Regjistri i Ortakeve").
- 9.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposthem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii) vleren nominale te kuotave; (iv) daten e fitimit te pronesise mbi kuotat nga cdo Ortak; (v) adresen apo seline e cdo Ortaku; (vi) detaje per cdo peng apo barre mbi kuotat.
- 9.3 Ortaket kane te drejte, nepermjet paraqitjes se nje kerkese me shkrim, te kerkojne nje ekstrakt te Regjistrimit te Ortakeve, me vulen e Shoqerise.
- 9.4 Ortaket kane te drejte te verifikojne regjistrimin e tyre ne Regjistrin e Ortakeve dhe Administratorin, nese i kerkohet me shkrim, do t'u jape Ortakeve ndihmen e nevojshme per kete qellim.
- 9.5 Te gjitha transferimet e kuotave do te behen ne perputhje me legjislacionin shqiptar te zbatueshem dhe kete Statut dhe do te regjistrohen ne Regjistrin e Ortakeve.
- 9.6 Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certifikate per kuoten e zoteruar prej tij. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjitha zoteruesve te kuotave, ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit. Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes. Ne asnje rast Certifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

Neni 10

Kalimi me Kontrate i Kuotave

- 10.1 Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.
- 10.2 Administratori mund te refuzoje regjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht.
- 10.3 Nese Administratori refuzon te regjistroje kalimin e kuotes, ai do te njoftojne Asamblene e Ortakeve brenda nje afati 5 ditor nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per regjistrimin e kalimit te kuotes.
- 10.4 Kalimi i te drejtave, venia peng, barre apo cdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do te kerkoje - ne menyre qe te prodhoje efekt - miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme - e cila do te marre vendim me shumicen e 75% te kuotova.
- 10.5 Nese nje Ortak ka per qellim te shese apo transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes mbi te gjitha apo nje numer te Kuotave te Ofruara. Kjo e drejte parablerjeje mund te ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren e meposhtme te percaktuar ne nenet 10.6 deri ne 10.8.
- 10.6 Nese nje Ortak ka per qellim te shese apo transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij ("Kuotat e Ofruara"), ai - perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket - do te njoftoje me shkrim Administratorin, per shitjen apo transferimin e planifikuar, ku te percaktoje gjithashtu edhe cmimin e shitjes/transferimit.
- 10.7 Administratori brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar - do te informoje me shkrim Ortaket e tjere. Sidoqoftë, kjo nuk aplikohet kur Administratori është në të njëjtën kohë edhe Ortak i Shoqërisë.
- 10.8 Ortaket e tjere qe kane te drejten e parablerjes sipas nenit 10.5 - brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratorit per shitjen apo transferimin e planifikuar do te njoftojne me shkrim Administratorin nese kane qellim te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes. Administratori - brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi - duhet te njoftoje Ortakun qe ka per qellim te shese/transferoje kuotat e tij.
- 10.9 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga Ortaket sipas nenit 10.8 me siper, Ortaku qe ka per qellim te shese/transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia shese/transferoje keto kuota nje pale te trete.
- 10.10 Nese Ortaku qe ka per qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes ka dhene njoftim, ky Ortak do te kete te drejte te bleje Kuotat e Ofruara - pjeserisht apo teresisht, sic percaktohet ne njoftimin e tij - brenda 30 diteve nga data e dorezimit te njoftimit te tij tek Administratori. Ne rast blerjeje te pjesshme te Kuotave te Ofruara - ne cdo rast ne perputhje me numrin e percaktuar ne njoftimin e derguar nga Ortaku bleres - pjesa e mbetur e Kuotave te Ofruara mund t'i ofrohet dhe te transferohet tek cdo pale e trete me

nje cmim shitjeje/transferimi jo me te ulet sesa ai i percaktuar ne njoftimin e permendur ne nenin 10.6.

Neni 11

Kalimi i kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit

- 11.1** Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave, dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij; pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk çlirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.
- 11.2** Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne QKR.

Neni 12

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

- 12.1** Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.
- 12.2** Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

Neni 13

Blerja e Kuotave te Veta

- 13.1** Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi i kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratori leshon nje certifikate te aftesise paguese te parashikuar nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit, padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit.

Kreu III Asambleja e Pergjithshme

Neni 14

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme



14.1 Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i audituesve ligjor
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
- m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

14.2 Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates.

14.3 Administratori therret Asamblene e Pergjithshme dhe, me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te Ligjit, do te procedoje me thirrjen e Asamblese se Pergjithshme.

14.4 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste (ose me format tjeter komunikimi perfshire edhe ate elektronik) drejtuar çdo ortaku, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 (shtate) Dite te Plota perpara dates se caktuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme i cili permban nje afat me te shkurter eshte miratuar nga te gjithë ortaket e shoqerise.

14.5 Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohen, vendin dhe rendin e dites te mbledhjes, informacion mbi vendin dhe menyren e marrjes se dokumenteve dhe te projekt-vendimeve qe duhet t'u vihen ne dispozicion dhe do t'u dergohen te gjithë Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit, Asambleja mblidhet perseri brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.

14.6 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te qellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

Neni 15

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- 15.1 Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 86 dhe 87 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*), audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit.
- 15.2 Kryetari i mbledhjes caktohet me shumice te thjeshte te kuorunit te parashikuar nga neni 86 dhe 87 i Ligjit, i cili cakton nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 15.3 Administratori, pavaresisht nese nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.
- 15.4 Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato çeshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.
- 15.5 Me perjashtim te kundershimit te nje ortaku, Kryetari deklaroi nese vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevojte per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.
- 15.6 Ne rast se ka kundershime per kete deklarate, do te zhvillohet edhe nje votim tjetër ne lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

Neni 16

Votat e Ortakeve

- 16.1 Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, çdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.
- 16.2 Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.
- 16.3 Çdo kundershim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

Neni 17

Votimi me Prokure

- 17.1 Perfaqesuesi do te emerohet nga ortaku nepermjet nje akti noterial sipas nje forme te percaktuar dhe miratuar nga Administratori. Cdo ortak nepermjet perfaqesuesit te tij mund te zgjedhe te votoje "PRO", "KUNDER" ose "ABSTENIM".
- 17.2 Akti perkates noterial i perfaqesimit depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise, siç percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaqesues te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Akti i emerimit te perfaqesuesit duhet te depozitohet jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre, ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.
- 17.3 Ne rast se akti i emerimit te perfaqesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te derguar ne adresen elektronike (*email*) te shoqerise, ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

Neni 18

Hetimet e posaçme

- 18.1 Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

Kreu IV Administratori

Neni 19

Emerimi i Administratorit

- 19.1 Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si Administratore te shoqerise per nje periudhe njevjecare, ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te nenit 81 dhe nenit 95 te Ligjit. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme, i cili, nese miratohet, sjell emerimin e personit te propozuar si Administrator.
- 19.2 Kufizimet ne lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen ne piken 2 te nenit 95 te Ligjit.
- 19.3 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i shoqerise per nje periudhe kohore 5-vjecare nga date e regjistrimit te shoqerise:

Bledar Habili shtetas shqiptar, lindur me 17.03.1985, banues ne Kavaje mbajtes i Leternjoftimit nr.032937248 dhe me numër personal № I50317110F .

Neni 20

Kompetencat e Administratorit



20.1 Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- ë) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

20.2 Administratorët jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- b) shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- c) shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

20.3 Nese asambleja e pergjithshme emerion me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

20.4 Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 21

Pergjegjesite e Administratorit

21.1 Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

- 21.2** Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 21.3** Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 21.4** Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 21.1 e 21.2 të këtij neni, është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 21.5** Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë dëm të shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakeve kontributet;
 - b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
 - c) u shperndan aktivitetit të shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.
 - d)
- 21.6** Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht Administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asambleës nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.
- 21.7** Pa u kufizuar sa më sipër, në mënyrë të veçantë Administratori ka këto kompetenca:
- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë personë I përkatëse administrimit të zakonshëm;
 - (ii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj
 - (iii) do të përgatitë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë e huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të

mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijojte nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice te thjeshte:

- (iv) do te urdherojte dhe kryejte pagesa ne emer te Shoqerise duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (v) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (vi) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (vii) do te krijojte nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (viii) do te kryejte regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (ix) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xii) do te marre ne pune, emerore, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktojte kompetencat dhe detyrat e tyre si dhe do te percaktojte shperblimin e tyre;
- (x) te kryejte detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 22

Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

- 22.1** Administratori shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te Ligjit.
- 22.2** Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojte perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/en, ish-bashkeshortin/en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.
- 22.3** Administratorit mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme apo mbledhje te tjera ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

Neni 23

Kufizimet ne Veprimet e Administratorit

- 23.1** Administratori nuk do te lidhi marreveshje per ceshtje ne te cilin ai ka, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundërshtim me

interesat e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithe anetaret kane rene dakord qe te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje.

- 23.2 Autorizimi mund te jete i pergjithshem ose i posaçem per nje çeshtje te caktuar. Autorizimi i pergjithshem duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Kreu V

Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 25

Dividendet

- 25.1 Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 25.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjithe dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi. Te gjithe dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjesetim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividendi; ne rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht.
- 25.3 Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

Neni 26

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

- 26.1 Administratorit, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, kryen te gjitha veprimet per te kaluar ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 27

Prishja dhe likuidimi

- 27.1 Shoqeria priset dhe kalon ne procedura likuidimi nese:
1. merret nje vendim i posacem i Asamblese se Pergjithshme;
 2. kalohet ne falimentim;
 3. ekziston nje vendim gjykate;
 4. per arsye te tjera te parashikuara ne kete Statut.

- 27.2 Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votave te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje çdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.
- 27.3 Administratori eshte i detyruar te regjistroje prishjen e Shoqerise ne QKR, me perjashtim te rastit kur prishja behet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata qe i dergon njoftimin QKR-se.

Neni 28 **Njoftimet**

- 28.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronikdhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin. Administratori ka detyrimin te percaktoje metodologjine e perdorimit te komunikimit elektronik perfshire nenshkrimin elektronik, per te siguruar nje shprehje te qarte te vullnetit te ortakeve apo personave te tjere.
- 28.2 Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortakut. Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenin 72 te Ligjit.
- 28.3 Ky Statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratoret ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 5 te ketij Statuti (nese zbatohet).

Neni 29 **Te Ndryshme**

- 29.1 Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 29.2 Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor te zbatueshem te Republikes se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 29.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbedhete) muaj, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 29.4 Ne fund te cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 29.5 Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare.


29.6 Per mosmarveshjet qe mund te linden ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linden midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

29.7 Ne kete statut:

1. "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
2. "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;
3. "Dite te Plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk e perfshin ditën kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditën per te cilën eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

Ortaket e Shoqerise

IZET SHEQIRI

IZET SHEQIRI 

BLEDAR HABIL

Bledar Habi

